



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 16.03.2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Saša Milosavljeviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novoberdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Nekibe Kelmendi.

Emrat e stafit mbështetës të Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatorë, Safet Beqiri – zyrtar për Integrime Evropiane dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumni Rama - OSBE, Dritero Arifi – Ministria e Integritimeve Evropiane, Venera Hajrullahu – KCSF, Arban Abrashi – Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Mbledhja konstituive e Komisionit

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Mbledhja konstituive e Komisionit

Kryetari e hapi takimin konstituiv të Komisionit për Integrime Evropiane duke i njoftuar se gjatë kësaj jave kryetarët e komisioneve kishim një takim me Kryetarin e Kuvendit duke theksuar se, komisionet parlamentare, e në veçanti komisionet e përhershme, kanë përgjegjësi më

të madhe dhe një rol më të madh sa i përket përmbushjes së agjendës dhe detyrave të tjera që dalin si obligim nga rregullorja e punës dhe e vendimeve të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit. Në vazhdim prezantoi dy nënkryetarët e Komisionit, Xhavit Halitin, nënkryetar i parë dhe Sasha Milosavljeviq, nënkryetar i dytë. Ne do ta hartojmë një plan të punës dhe do ta bëjmë në përputhje me agjendën legjislative të Qeverisë.

Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës është i domosdoshëm, një pjesëmarrje ma aktive dhe ma dinamike e kësaj ministrie është e domosdoshme, por ky Komision ka autoritet dhe ndaj ministrive të tjera për të kërkuar shtyrjen e të gjitha proceset dhe agjendat e BE - së. Më tutje prezantoi stafin mbështetës të Komisionit dhe stafin që do të monitorojë punën e Komisionit nga KCSF, OSBE ,UNDP, etj. Pasi që mbledhjet janë të hapura tha se do të kemi bashkëpunim.

Në vazhdim fjalën e mori Xhavit Haliti, nënkryetar i parë.

Xhavit Haliti - Theksoi se ky komision në mandatin e kaluar e ka kryer mirë punën e tij dhe ka qenë mjaft i suksesshëm. Pasi që është komision i përhershëm, të gjitha ligjet kalojnë përmes tij, shpresoj që Qeveria ose Ministria përkatëse do të jetë raportuese e rregullt. Ajo duhet të raportojë rregullisht në këtë komision, pra, në raportim vjen vetë ministrja për Integritet Evropian, të raportojë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integritet evropian. Ne jemi në një situatë të palakmueshme në aspiratën tonë për integritet, sepse Kosovën, si shtet, nuk e kanë njohur pesë vende anëtare të BE - së.

Ne do të punojmë për t'i përmbushur kërkesat që i ka BE - ja për Kosovën, legjislacionin ta bëjmë në përputhje me atë të BE - së dhe të arrijmë liberalizimin e vizave. Kjo varet prej shumë faktorëve si të brendshëm dhe të jashtëm, varet shumë edhe prej punës së Qeverisë dhe nga detyrat që i kryejmë dhe që na takojnë. Anëtarët e këtij komisionit janë të gjithë me përvojë të mirë politike dhe të punojmë së bashku si ekip për interes të legjislativit dhe detyrave që kemi. Ne këtë komision nuk kemi dëshirë që të ketë përplasje politike, sepse interesat nuk janë politike.

Blerim Shala - Tha se ky komision do të punojë pa dallime se kush është në pozitë dhe kush në opozitë, shpresojmë që Kosova sa më shpejt të vendosë raporte të mirëfillta me BE - në, pasi që vetë, si shtet, jemi definuar si “sui generis”, të gjithë hapat e tjerë po shkojnë “sui generis” edhe në fjalorin e BE – së. Ne jemi rast i veçantë, siç e dimë, nuk do të marrim udhërrëfyes për liberalizim të vizave, por do ta kemi një strategji për liberalizim të vizave. Ne të punojmë siç është paraparë me rregulloren e Kuvendit dhe sa ma shumë që është e mundur ta obligojmë ministrinë që sa ma shumë të punojë në krijimin e raporteve sa më të mira me BE - në edhe pse ajo çështje nuk varet vetëm nga ministria, po varet edhe prej BE - së, prej Qeverisë dhe prej

gjithë neve edhe si shoqëri. Do të punojmë të gjithë së bashku dhe shpresoj se do të jem një ndër komisionet më të mira parlamentare.

Vjosa Osmani – Theksoi se pret një bashkëpunim të mirë prej secilit anëtar në Komision, sepse secili prej tyre mund të japë një kontribut të madh. Pajtohet me parafolësit Shala dhe Haliti se agjenda politike nuk duhet të ndikojë, sepse ne kemi synim të përbashkët sa i përket agjendës evropiane. Sa i përket volumit dhe shpejtësisë së punës aty do të kemi vështirësi. Mirëpo në qoftë se ne do të kemi parasysh interesat e vendit natyrisht se këto vështirësi do t'i tejkalojmë.

Alma Lama - Tha se Qeveria duhet të vazhdojë plotësimin e standardeve të Bashkimit Evropian, pavarësisht që nuk e kanë njohur pesë vende, kjo nuk është ndonjë fakt që ne dita - ditës me aktorët e BE - së të mos angazhohemi për standarde më të mira. Prandaj mendojmë që edhe Ministria e Integritetit Evropian duhet të raportojë për punën e saj, por me gjithë vështirësitë që vijnë, standardet janë kudo në çfarëdo hapi dhe duhet të jenë prezent në fokusin e punës tonë.

Sasha Milosavljeviq - Theksoi se si nënkryetar e pranon pozitën me përgjegjësi dhe konsideron se puna e ekipit është në vend të parë dhe nuk dyshon në bashkëpunim e ndërsjellët. Fushëveprimet e këtij komisioni janë shumë të rëndësishme dhe me interes për të gjithë qytetarët e Kosovës, pra integrimi në Bashkimin Evropian. Hap tjetër i rëndësishëm është liberalizimi i vizave, i cili tash ju mungon qytetarëve të Kosovës, e që duhet të punohet për të arritur këtë objektiv.

Albert Kinolli – Si deputet i cili për herë të parë flet në Kuvendin e Kosovës shpreson se kanë çka të mësojnë nga përvoja e deputetëve të mëparshëm. Edhe sa i përket bashkëpunimit do ta kenë edhe ndihmën profesionale. Ne, si ekip, mendojmë se do të punojmë mirë. Për ne ky komision është i ndjeshëm dhe për të gjithë qytetarët të cilët presin liberalizimin e vizave. Prandaj shpresojmë në konstruktivitetin e tij dhe besojmë se nuk do të mungojë bashkëpunimi.

Blerta Deliu- Kodra – Tha se për mua është nder dhe privilegj të jem në këtë komision. Jam deputete e re dhe po ashtu është nder që jam bashkë me Xhavit Halitin dhe Lutfi Hazirin. Shpresojmë se do të kemi përkrahjen për shkak të eksperiencës së tyre. Mendoj se edhe opozita ka me qenë shumë bashkëpunuese, siç ka qenë edhe në legjislaturën e kaluar, dhe po ashtu Qeveria do t' na ndihmojë dhe do të kemi një bashkëpunim të mirë.

Suzana Novoberdali – Uroj kryetarin për përvojën dhe përgatitjen e tij. Synimi ynë është liberalizimi i vizave dhe hyrja në familjen e madhe evropiane. Kështu që ne do të japim

kontributin tonë në këtë komision dhe do të kemi bashkëpunim pa marrë parasysh pozitën politike të partive politike. Uroj që ky komision të këtë punë të mbarë.

Kryetari – Tha se natyrisht që na presin punë të mëdha, i gjithë legjislacioni do të kalojë nëpër këtë komision, do të fillojmë shumë shpejt me buxhetin në javën e ardhshme dhe agjenda do të jetë shumë e ngjeshur. Kemi pesë shtete që nuk e kanë njohur Kosovën dhe bllokimin e liberalizimit të vizave, ku duhet të gjinden modalitete për të ecur përpara. Ne do të kemi dy takime në muaj në mënyrë të obliguar, por sipas volumit të punëve do të kemi shumë ma shumë takime.

I njoftoj anëtarët se të martën e ardhshme në orën 12:00, do të jetë një takim pune me ministren e Integritetit Evropian, Vlera Çitaku, kurse agjenda do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Në fund të diskutimit tha se për mungesa eventuale të kryetarit, nënkryetari i parë mund ta udhëheq me autoritet të plotë mbledhjen e Komisionit, kurse në mungesë të tij edhe nënkryetari i dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri